

KUSHTET E PERGJITHSHME TE BIZNESIT



SHËNIM I RËNDËSISHËM

Kushtet e Pergjithshme te Biznesit hartohet ne dy gjuhe: shqip dhe anglisht. Në rast mosperputhje në interpretim midis te dy versioneve, i vetmi qe do te kete vlerë ligjore është versioni ne shqip i këtij dokumenti. Kushtet e Përgjithshme të Biznesit janë pjesë integrale e çdo marrëveshjeje në të cilën Banka hyn me Klientët e saj.

Intesa Sanpaolo Bank Albania
Nentor 2008



I. KUSHTET E PERGJITHSHME

1

1. Fusha e zbatimit
2. Pranimi i Kushteve të Përgjithshme të Biznesit
3. Konfidencialiteti dhe Sekretet Bankar
4. Bashkëpunimi dhe Informacioni
5. Përfaqësimi
6. Përgjegjësitë e Bankës
7. Mjetet dhe Format e Komunikimit
8. Vendi dhe Koha e Ekzekutimit
9. Dërgimi i Dokumenteve

II. URDHERAT E PAGESES DHE LLOGARITE BANKARE

10. Pranimi i Urdhrave
11. Ekzekutimi i Urdhrave
12. Tërheqja dhe Modifikimi i Urdhrave
13. Hapja e Llogarisë
14. Deklarata e Llogarisë
15. E drejta e Kompensimit

III. TRANSAKSIONE TE VEÇANTA

16. Depozitat
17. Kreditë
18. Kambialet dhe Çeqet
19. Letrat e kreditit
20. Paraqitja e dokumenteve për pagesë
21. Garancitë Bankare dhe Obligacionet (Surety)
22. Shërbimet e Ruajtjes së Letrave me Vlerë
23. Transaksionet e Këmbimit Valutor
24. Shërbime bankare on-line

IV. KOLATERALET

V. TE DREJTAT E BANKES NE RASTE SHKELJESH (MOSPERMBUSHJEJE)

VI. ZGJIDHJA E KONTRATES NGA BANKA

VII. TARIFAT PER BANKEN

28. Interesi
29. Tarifa
30. Tarifa për shërbime juridike
31. Kosto të tjera

VIII. TE NDRYSHME

32. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve
33. Ndarja e ndikimit të dispozitave tek njëra tjetra
34. Legjislacioni i Zbatueshëm

I. KUSHTET E PERGJITHSHME

1. FUSHA E ZBATIMIT

1.1. Kushtet e Përgjithshme të Biznesit (Këtej e tutje: KPB) rregullojnë kushte të përgjithshme të marrëdhënieve bankare ndërmjet personave fizikë e juridikë, shqiptarë dhe të huaj (këtej e tutje: Klienti) dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania SH.A. (këtej e tutje: Banka).

1.2. Kushtet e KPB janë të detyrueshme si për Bankën ashtu edhe për Klientin dhe bazohen në dispozitat ligjore dhe praktikat ndërkombëtare të zbatuara në këtë fushë. Në rastin e kontratave ose transaksioneve të vecanta ndërmjet palëve, dhe duke respektuar legjislacionin, dispozitat e kontratave të vecanta ose transaksioneve specifike mund të devijojnë nga dispozitat e KPB, dhe në këtë rast dispozitat e kontratave të vecanta do të mbizoterojnë ndaj atyre të KPB.

1.3. Gjithë çështjet që nuk rregullohen nga KPB ose nga kontratat e veçanta do të rregullohen nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, rregulloret në fuqi të Bankës së Shqipërisë dhe aktet ligjore e nenligjore të aplikueshme të Republikës së Shqipërisë.

2. Pranimi i KPB

2.1. Pranimi nga Klienti të KPB do të jetë një kusht paraprak që Banka të hyjë në cdo lloj marrëdhënieje kontraktuale me Klientin. Banka i jep një kopje të KPB cdo klienti të saj për t'u njohur me to dhe për të rënë dakort, ose KPB vihen në dispozicion të Klientit në mjediset e Bankës brenda orarit normal të punës. Banka mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me Klientin pasi klienti pranon KPB të shpallura nga ana e Bankes.

2.2. Banka do të ketë të drejtë të modifikojë KPB në cdo kohë.

3. Konfidencialiteti dhe Sekretet Bankar

3.1. Banka dhe punonjësit e saj trajtojnë si konfidencial, sipas nenit 23 të Ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" (dhe cdo modifikim të tij), akteve nenligjore, Rregulloreve të Bankes së Shqipërisë dhe praktikës ndërkombëtare, gjithë informacionin e përfshirë për shkak të marrëdhënieve bankare me Klientët, duke përfshirë por

duke mos u kufizuar vetëm në identitetin dhe gjendjen financiare të Klientit.

3.2. Banka mund t'i japë një pale të tretë informacionin bankar të kërkuar lidhur me gjendjen financiare të Klientit vetëm nëqoftëse është e autorizuar me shkrim nga Klienti dhe vetëm në masën e autorizuar nga Klienti. Megjithatë, Banka mund të japë informacionin lidhur me Klientin kur ne zbatim te dispozitave ligjore, ky informacion kerkohet nga Banka e Shqipërisë, organet e Prokurorisë, Gjykata, Zyra e Permbartimit, Autoritetet Tatimore Qendrore dhe Vendore, si dhe cdo organ tjetër që e gezon kete te drejte ne baze te ligjit. Informacioni lidhur me Klientin mund t'i jepet edhe ekspertit kontabel te autorizuar te Bankës, si dhe kur e kerkon mbrojtja e interesave te Bankës në procedurat ligjore. Në raste të tilla, kur konfidencialiteti kufizohet ose përjashtohet me ligj, Banka nuk do të jetë përgjegjëse për pasojat që mund t'i vijne Klientit.

3.3. Klienti mban përgjegjësi për të ruajtur konfidencialitetin e marrëdhënieve të tij me Bankën, dhe të cdo marrëveshjeje me gojë ose me shkrim në lidhje me të. Klienti detyrohet të mos u japë informacion palëve të treta në lidhje me ndonjë marrëveshje me gojë ose me shkrim me Bankën nëqoftëse nuk ka miratimin paraprak me shkrim nga Banka. Gjithashtu, Klienti është i detyruar të mos u japë palëve të treta informacion rreth operacioneve të Bankës dhe KPB. Shkelja e kësaj dispozite konsiderohet si një shkelje serioze e marrëdhënieve të biznesit dhe atyre juridike të Klientit dhe Bankës.

3.4. Pavarësisht nga sa u përmend më sipër, dhe subjekt i ligjeve në fuqi, Klienti autorizon Bankën për t'i bërë të njohur cdonjëri prej degëve të saj cdo hollësi lidhur me Klientin dhe marrëdhëniet ndërmjet Klientit dhe Bankës që Banka e gjykon se mund të jenë të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin me Klientin.

4. Bashkëpunimi dhe Informacioni

4.1. Banka dhe Klienti do të kryejnë detyrimet e tyre kontraktuale në frymën e bashkëpunimit reciprok dhe mirëbesimit. Ata do të informojnë menjëherë njëri tjetrin për gjithë faktet, rrethanat dhe ndryshimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me transaksionet e tyre.



4.2. Klienti detyrohet të informojë Bankën pa vonesë për cdo ndryshim që ndikon në identitetin ose statusin e tij ligjor, që afekton edhe kryerjen e veprimeve bankare nga Klienti, si dhe të vërë në dispozicion të Bankës aktet e nevojshme për reflektimin e ndryshimit. Në rastin e humbjeve të Klientit ose të ndonjë pale të tretë, si rezultat i mospërmbushjes nga Klienti të detyrimit për të informuar Bankën për ndryshimet e ndodhura, ose kur ky informacion është dhënë në një moment që Banka nuk mund ta evitonte këto humbje, Banka nuk do të mbajë përgjegjësi për humbje të tilla.

4.3. Klienti do të japë gjithë informacionin, e kërkuar nga Banka për vlerësimin e Klientit. Për këtë qëllim, Klienti duhet t'i japë Bankës një kopje të bilancit të tij vjetor dhe, me kërkesën e Bankës, duhet ta lejojë atë, gjatë orarit të punës, për të vëzhguar librat dhe të dhënat e kontabilitetit.

4.4. Klienti do të njoftojë menjëherë Bankën me shkrim për:

- cdo ndryshim në gjendjen e tij financiare - duke përfshirë vecanërisht rastet kur Klienti shpall paaftësinë e tij paguese ose kur ka filluar një procedurë likuidimi ndaj Klientit në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8017 "Për procedurat e falimentimit" (dhe modifikime apo amendamente të mundshme);
- cdo ndryshim në organet vendimmarrese ose ekzekutive të shoqërisë, percaktuar në Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" (dhe modifikimet apo amendamentet e mundshme),,
- konfliktet gjyqësore të cdo natyre dhe objekti.

4.5. Klienti duhet të njoftojë menjëherë Bankën për cdo ndryshim në kushtet e tij ekonomike të cilat mund të influencojnë negativisht përmbushjen e detyrimeve të tij kontraktuale kundrejt Bankës.

4.6. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të percaktuara në këto nen, Banka do të ketë të drejtë sipas vendimit dhe gjykimit të vetëm të saj, të zgjidhë marrëdhënien bankare me Klientin, dhe nëse është rasti të kërkojë kthimin e cdo shume monetare dhe shperblimin e demit kundrejt Klientit.

5. Përfaqësimi

5.1. Banka është një shoqëri anonime e themeluar sipas ligjeve dhe akteve nenligjore të Shqipërisë, veprimtaria bankare ushtrohet në perputhje të plotë dhe në zbatim të ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera nenligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

5.2. Banka ka të drejtë para se të hyjë në një transaksion biznesi, dhe në çdo kohë më pas, të kërkojë prova nga Klienti për identitetin e tij sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Megjithatë, Banka nuk ka përgjegjësi për të hetuar identitetin e Klientit. Banka ka të drejtë të bëjë dhe mbajë në dosjet e saj një fotokopje të çdo dokumenti origjinal të paraqitur nga Klienti, i cili duhet të vërtetohet nga Banka që është një me origjinalin.

5.3. Në rastin e një shoqërie - person juridik shqiptar

- Banka do të kërkojë kopje autentike të dokumentave të mëposhtem:
- Akt Themelimi dhe Statuti i shoqërisë;
- Çertifikata e Regjistrimit Fillestar (për rastet kur shoqëria është themeluar si person juridik dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar pas datës 01.09.2007);
- Vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik të shoqërisë; të gjitha Vendimet e Gjykatës për de pozitim në Regjistrin Tregtar, Certifikatën e Regjistrimit Tatimor, NIPT-in, Kodin Fiskal si dhe çdo dokument që vërteton regjistrimin në Autoritetet tati more (për rastet kur shoqëria është themeluar si person juridik dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar për para datën 01.09.2007);
- Ekstrakti i lexuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me të gjitha të dhënat e regjistruara dhe kopje të vërtetuara të dokumenteve shoqëruese të de pozituara në Regjistrin Tregtar;
- kopje origjinale të firmës së përfaqësuesit të caktuar të shoqërisë në marrëdhënie me Bankën,
- Prokurën për personin e caktuar sipas legjislacionit në fuqi dhe dispozitave statutores për të përfaqësuar shoqërinë.

Përveç sa përcaktohet më sipër, Banka mund të kërkojë edhe prova të tjera që sipas gjykimit dhe vlerësimit të Bankës janë të nevojshme për të hyrë në marrëdhënie bankare me Klientin.

Banka mund të pranojë si të mirëqënë autenticitetin e dokumenteve të tilla, por mund edhe të kërkojë konfirmim për autenticitetin e dokumenteve.

5.4. Në rastin e një personi juridik të huaj, i cili hap Dege dhe/ose Zyre Perfaqesimi ne territorin shqiptar, Banka do të kërkojë kopje autentike te dokumentave te meposhtem:

- Aktin e themelimit e Statutin e shoqerise se huaj (kur keto jane te vecanta), si dhe dokumentacionin qe verteton regjistrimin si person juridik te shoqerise se huaj ne juridiksionin e huaj;
- Vendimin ose aktet e tjera te organit perkates te shoqerise se huaj, per hapjen e Deges ose Zyres se Perfaqesimit.
- Certifikaten e Regjistrimit Fillestar (per rastet kur shoqeria eshte themeluar si person juridik dhe regjis truar ne Regjistrin Tregtar pas dates 01.09.2007);
- Vendimin e Gjykates per regjistrimin ne Regjistrin Tregtar te Deges ose Zyres se Perfaqesimit , te gjitha Vendimet e Gjykates per depozitime ne Regjistrin Tregtar, Certifikaten e Regjistrimit Tatimor, NIPT-in, Kodin Fiskal etj, (per rastet kur Dega ose Zyra e Perfaqesimit eshte krijuar dhe regjistruar ne Regjistrin Tregtar perpara dates 01.09.2007);
- Ekstrakti leshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me të gjitha të dhënat e regjistruara dhe kopje te vertetuara te dokumenteve shoqeruese te depozituara ne Regjistrin Tregtar;
- Kopje origjinale të firmave (nënshkrimeve) te perfaqesuesit te caktuar per te perfaqesuar Degen apo Zyren e Perfaqesimit ne marredhenie me Banken;
- Prokurën për personin e caktuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat statutore, për të përfaqësuar Degen ose Zyren e Perfaqesimit.

Pavec sa percaktohet me sipër, Banka mund te kerkoje edhe prova te tjera qe sipas gjykimit dhe vleresimit te Bankes jane te nevojshme per te hyre ne marredhenie bankare me Klientin.

Banka mund të pranojë si të mirëqënë autenticitetin e dokumenteve të tilla, por mund edhe të kërkojë konfirmim për autenticitetin e dokumenteve.

5.5. Klienti do të njoftojë Bankën, në formën e kërkuar nga Banka për emrat dhe firmat e personave të autorizuar për të vepruar në emër të Klientit. Cdo kompetencë ose

përfaqësim (prokurë) do të konsiderohet i vlefshëm derisa të revokohet me shkrim nga personi i autorizuar për të bërë këtë. Klienti do të jetë përgjegjës për të njoftuar menjëherë Bankën për cdo ndryshim lidhur me personat e autorizuar dhe për t'u siguruar që është reflektuar ky ndryshim nga Banka sipas procedurave të brendshme të saj. Klienti do të zhdëmtojë Bankën për cdo dëmtrim ose humbje të shkaktuara nga mosrespektimi i këtij detyrimi. Në rast të kryerjes së veprimeve bankare nga personi ose personat që kanë vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë, tagrat e përfaqësimit të të cilit/cileve në momentin e kryerjes së veprimit kanë mbaruar dhe nëse Banka nuk është njoftuar zyrtarisht nga shoqëria për mbarimin e tyre, Banka është e përjashtuar nga cdo lloj përgjegjësie kundrejt Klientit dhe/ose personave të tjerë. Banka do të konsiderohet në mirebesim dhe për këtë arsye nuk do të mbaje asnjë përgjegjësi. Klienti heq dorë nga cdo lloj pretendimi kundrejt Bankes dhe garanton se do të marrë të gjitha masat për të ruajtur Bankën të padëmtuar nga cdo pretendim i personave të tjerë për kthim shumë dhe/ose shperblim demi etj.

5.6. Në rast se ka një mosmarrëveshje ligjore në lidhje me personat e autorizuar ndërmjet ortakeve/aksionerëve, apo administratorëve/drejtorëve të një shoqërie dhe një prej tyre njofton Bankën për këtë mosmarrëveshje, Banka do të ketë të drejtë sipas gjykimit dhe vendimit të vetëm të saj, të pezullojë gjithë transaksionet dhe mos kryejë veprime bankare në emër të shoqërisë, derisa të zgjidhet mosmarrëveshja.

5.7. Në rast të ndryshimit të përfaqësuesit të shoqërisë në marrëdhënie me Bankën, ndryshim ky për të cilin është marrë vendim nga organi vendimarrës kompetent i shoqërisë dhe ende nuk është kryer regjistrimi i këtij ndryshimi në Regjistrin Tregtar, Banka mund, por nuk është e detyruar, të pezullojë kryerjen e veprimeve të kerkuara bankare dhe nuk mban asnjë përgjegjësi për kryerjen dhe/ose refuzimin e kryerjes së veprimeve të kerkuara bankare deri në depozitimin e ndryshimit respektiv pranë Bankes.

6. Përgjegjësitë e Bankës

6.1. Banka nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet që rezultojnë nga veprimet e autoriteteve vendase ose të huaja, mohimi ose dhënia me vonësë e autorizimeve të nevojshme nga autoritetet, ose të shkaktuara nga ngjarje




të imponuara ose të paevitueshme duke përfshirë, por pa u kufizuar në, konflikte të armatosura, revolucione, gjendje të jashtëzakonshme kombëtare, trazira, fatkeqësi natyrore, avari ose pamundësi për transmetim ose komunikim, çrregullimet e tregut, grevat, konfliktet në marrëdhëniet e punës ose rrethana të tjera që nuk mund të kontrollohen nga Banka (të gjitha së bashku: Forca Madhore) dhe për dëme që rrjedhin nga ngjarje për të cilat Banka nuk mund të mbajë përgjegjësi, ose për dëme të cilat rezultojnë te jene shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e Klientit dhe nga ngjarje të cilat janë nën kontrollin ose ndikimin e Klientit, ose nga mos-pranimi ose pranimi me vonesë nga Klienti të dispozitave të KPB.

6.2. Klienti pranon se Banka nuk do të jetë përgjegjëse ose e detyruar ndaj tij për cdo zbritje që rrjedh nga pagesat e tatimeve, detyrimeve ose rënies në vlerë të fondeve të kredituara në llogarinë e Klientit (fonde të cilat mund të jenë depozituar nga Banka në emër të Bankës dhe subjekt i kontrollit të Bankës me depozitues të tillë që Banka mund të zgjedhë), ose për mungesë të disponibilitetit të fondeve të tilla për shkak të kufizimeve në konvertimin dhe/ose transferimin, konfiskimeve, dhe/ose sekuestrimeve, akteve të luftës ose konflikteve civile, sekuestrimeve të cdo lloji, ushtrimit të pushtetit ushtarak ose të uzurpuar, ose shkaqeve të tjera të ngjashme që nuk mund të kontrollohen nga Banka.

6.3. Banka ka të drejtë të zgjedhë një palë të tretë si korrespondent ose agjent sipas gjykimit të saj më të mirë, ose nëqoftëse Klienti në udhëzimin e tij përcakton një palë të tretë konkrete, për ta përdorur atë në masën e nevojshme për kryerjen e detyrimeve kontraktuale të Bankës. Banka do të ushtrojë kujdesin e duhur profesional për zgjedhjen, këshillimin, dhe kontrollin e kësaj pale të tretë, dhe nuk do të jetë përgjegjëse për demet që mund të vijne nga veprimet ose neglizhencat e kesaj pale të tretë. Nëqoftëse detyrimi i palës së tretë kufizohet me ligj ose rregullore biznesi, detyrimi i Bankës do të rregullohet në pajtim me të.

Ne rastet kur një llogari ka si titullare me teper se një person, atehere Klientet bien dakort qe statusi "VETEM" i llogarise rrjedhese ka kuptimin qe secili prej tyre ne menyre te pavarur nga njeri-tjetri dhe te drejtperdrejte te kete te drejte te kerkoje nga Banka ekzekutimin e cdo urdherimi nga ana e secilit prej tyre ndarazi pa kufizim



shume apo natyre akti, ku perfshihen veprime bankare si debitimi i llogarise rrjedhese, terheqja e shumave, derdhja, transferimi, negocimi dhe celja e depozitave te kursimit, si dhe cdo veprim tjetër bankar me llogarine, titullare te se ciles titullaret jane, pervec mbylljes se llogarise dhe shtimit apo heqjes se personave, qe kane cilesine e firmave te autorizuara per te cilat titullarët e llogarisë vendosin vetem se bashku.

Kuptimi i statusit “E PERBASHKET” nënkupton se transaksionet bankare mund të ekzekutohen vetëm me nënshkrimin e të gjithë titullarëve të llogarisë, të cilët së bashku mund t’i kërkojnë Bankës ekzekutimin e një urdhër pagese, pa limit shume ose natyrë akti, përfshi por jo duke u kufizuar vetëm për transaksionet bankare si debitim, tërheqje, depozita, transferta, bisedime dhe hapjen e nënllogarive, si dhe çdo transaksion tjetër bankar që kryhet në një llogari të përbashkët.

Banka nuk do të ekzekutojë transaksione bankare që urdhërohen nga një ose disa titullarë të llogarisë, pavarësisht nga qëllimi ose tipi i transaksioneve bankare, përveçse kur titullarët e llogarisë i transferojnë njërit ose disa prej titullarëve të llogarisë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të bankës, të drejtën e përfaqësimit për kryerjen e transaksioneve të veçanta bankare.

7. Mjetet dhe Format e Komunikimit

7.1. Klienti mund të përdorë metodën elektronike të transmetimit të Bankës për të komunikuar me zyrat e Bankës. Përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, Klienti mund gjithashtu të përdorë postën rekomande, teleks të testuar ose SWIFT autentik, ose cdo transmetim tjetër manual për të komunikuar me Bankën. Banka do të pranojë udhëzime vetëm nga Klienti dhe individët e caktuar nga Klienti si perfaqesues te tij të cilët janë autorizuar nga Klienti për ta perfaqesuar ate ne kryerjen e veprimeve brenda tagrave te perfaqesimit.

7.2. Banka nuk do të ketë për detyrë të verifikojë përmbajtjen ose identitetin e dërguesit ose konfirmuesit të një udhëzimi ose komunikimi të marrë nëpërmjet transmetimit manual dhe Klienti do të jetë i detyruar t’i njohë ato, dhe Banka është e detyruar t’i pranojë ato. Megjithatë, Banka do të ketë diskrecion të plotë për të vepruar ose jo sipas udhëzimeve te mesiperme, dhe/ose të kërkojë verifikimin e vlefshmerise dhe vertetesise

te një transmetimi të marrë nga procedurat manuale. Banka do të ketë të drejtë të shtyjë afatin e veprimit derisa Klienti të dërgojë verifikimin në Bankë.

7.3. Klienti është në dijeni që procedurat e sigurimit të dhëna nga Banka janë hartuar për të verifikuar burimin e një komunikimi dhe jo për të kapur gabimet në transmetim ose në përmbajtje.

7.4. Përveç rasteve të neglizhencës serioze të Bankës, keqbesimit ose shkeljes së vullnetit të etikës, për aq kohë sa Banka vepron në përputhje me Kushtet e Përgjithshme të Biznesit dhe ligjet në fuqi, Banka do të jetë e cilituar nga të gjitha përgjegjësitë për shkaktimin e demit dhe nuk do të ketë detyrime për ndonjë shpenzim ose humbje të pësuar nga Klienti për shkak të mashtrimit, udhëzimeve dublikate ose të gabuara të nxjerra nga Klienti.

7.5. Banka gezon të drejtën të refuzojë ekzekutimin e udhëzimeve të marra pa përdorimin e formularëve të përgatitur ose të miratuar nga Banka ose të transmetuar nëpërmjet transmetuesve të të dhënave, ose mjeteve të tjera të komunikimit të pamiratuara nga Banka.

7.6. Formularët, transmetuesit e të dhënave, pajisjet dhe mjetet e komunikimit të cilat Banka ka vënë në dispozicion të Klientit duhet të mbahen dhe trajtohen nga Klienti me kujdesin e duhur dhe do të përdoren sipas kushteve të një kontrate të vecantë të lidhur ndërmjet Klientit dhe Bankës për këtë qëllim.

7.7. Nëqoftëse Klienti vihet në dijeni për parregullsi të tilla si humbje, vjedhje ose keqpërdorim në lidhje me këto formularë, transmetues të dhënash, pajisjesh të mjeteve të komunikimit, Klienti duhet të njoftojë menjëherë Bankën. Derisa njoftimi të merret si duhet nga Banka, Klienti në mënyrë të përvokueshme pranon se Banka nuk mban përgjegjësi për pasojat e shkaktuara dhe menjehere me kërkesën me të parë të Bankës detyrohet të dëmshpërblejë dhe ruajë Bankën të paprekur kundrejt çdo lloj humbjeje dhe të paguajë Bankën për shuma të tilla.

7.8. Në rast se marrëdhëniet e biznesit ndërmjet Klientit dhe Bankës ndërpriten, Klienti duhet t'i kthejë Bankës menjëherë gjithë formularët e papërdorur si edhe transmetuesit e tjerë të të dhënave, pajisjet, softet dhe

mjetet e komunikimit që Banka i ka dhënë Klientit.

7.9. Banka pranon gjithë udhëzimet ose komunikimet e dhëna ose të bëra me faksimile për të cilat kërkohet një konfirmim me shkrim për t'u dërguar në Bankë në të njëjtën ditë. Konfirmimi me shkrim do të përmbajë një referencë të qartë në udhëzimet ose komunikime të tjera të dhëna me faksimile dhe fjala "KONFIRMIM" duhet të shkruhet atje.

7.10. Përderisa nuk bihet dakort ndryshe Banka nuk do të pranojë udhëzime nga Klienti nëpërmjet telefonit.

8. Vendi dhe Koha e Përbushjes

8.1. Përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, vendi i përbushjes të detyrimeve kontraktuale të rrjedhura nga marrëdhëniet e biznesit ndërmjet Klientit dhe Bankës do të jenë mjediset e Bankës ku mbahet llogaria e Klientit ose, në mungesë të një llogarie të tillë, në zyrën kryesore të Bankës. Me mjediset e Bankës do të kuptohen zyrat qendrore të saj si dhe cdo dege ose agjensi.

8.2. Në rastin kur llogaritë e Klientit mbahen nga Banka, data e hyrjes në fuqi të cdo pagese të bërë nga Klienti do të konsiderohet data në të cilën llogaria e Klientit është debituar nga Banka. Për shumat e marra nga Banka në favor të Klientit, Banka do të kreditojë shumat në llogarinë e Klientit kur shumat të tilla vihen në dispozicion të Bankës.

8.3. Në rastin kur llogaritë e Klientit nuk mbahen nga Banka, data e kryerjes së pagesës në favor të Bankës është data kur shumat kreditohet në llogarinë e treguar nga Banka.

8.4. Data e përbushjes së një detyrimi për të paguar të Bankës është data në të cilën llogaria e Bankës është debituar.

9. Dërgimi i Dokumenteve

9.1. Përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, metoda e dërgimit të dokumenteve nga Banka do të vendoset nga vetë Banka sipas gjykimit të saj.

9.2. Përderisa nuk është udhëzuar ndryshe nga Klienti, Banka do të dërgojë dokumente të tilla si kambiale,

ceqe, dhe vlera të tjera sipas metodës së gjykuar prej saj duke ushtruar kujdesin e duhur profesional. Kostot dhe rreziku i dërgimit do të mbulohen nga Klienti.

9.3. Cdo postë dërguar nga Banka për Klientin në adresën e dhënë nga Klienti do të gjykohet se është marrë në kohën që normalisht Zyrës Postare i duhet për të dërguar një letër. Cdo njoftim i dërguar nga Banka në teleksin e Klientit, ose numrin e teleksit, faksit ose e-mailit (postes elektronike) të dhënë nga Klienti do të gjykohet se është marrë në datën e transmetimit të njoftimit.

9.4. Klienti do të informojë menjëherë Bankën nëqoftëse një njoftim me shkrim që pritët të vijë nga Banka nuk është marrë, ose nuk është marrë në kohën e duhur. Nëqoftëse Klienti nuk njofton në këtë rast, Banka nuk do të jetë përgjegjëse për humbjen e rezultuar.

II. URDHERAT E PAGESES DHE LLOGARITE BANKARE

10. Pranimi i Urdhrave

10.1. Urdhërat duhet të jepen me shkrim ose në formën e rënë dakort nëpërmjet Klientit dhe Bankës. Banka do të pranojë vetëm urdhra të cilat janë në përputhje me kërkesat e Bankës ose të cilat janë dhënë në një formular të vecante të përdorur nga Banka për këtë qëllim. Urdhra që shmangen nga kjo kërkesë mund të refuzohen nga Banka duke e njoftuar Klientin për refuzim.

10.2. Banka shqyrton udhëzimet me shkrim të Klientit lidhur me llogarinë e tij bankare dhe transaksione të tjera bankare për të vërtetuar që firmat janë identike me firmën e Klientit të depozituar në Bankë. Banka do të refuzojë të zbatojë udhëzimet të cilat nuk janë firmosur në përputhje me firmën e depozituar në Bankë dhe do të njoftojë Klientin për këtë. Banka nuk do të mbajë detyrimin për pasojat e ekzekutimit të udhëzimeve jo të verteta ose mashtruese, natyra mashtruese e të cilave mund të mos zbulohet edhe pasi është bërë kujdesi i duhur në shqyrtimin e tyre. Dëmet, humbjet dhe/ose kostot lidhur me to do të mbulohen vetëm nga Klienti.

10.3. Banka do të refuzojë të ekzekutojë urdhrin në rast se Banka verën që Klienti ka shkelur ligjet dhe rregulloret

përkatëse dhe do të njoftojë për këtë Klientin.

10.4. Në ekzekutimin e urdhrave Banka kërkon që Klienti t'i japë Bankës të dhëna të sakta dhe korrekte që nevojiten për një ekzekutim të tillë, në mungesë të të cilave Banka mund të refuzojë të ekzekutojë urdhrin. Banka nuk është e detyruar të verifikojë korrektësinë dhe saktësinë e të dhënave që Klienti i ka dhënë Bankës. Banka nuk do të jetë përgjegjëse për dëmet ose humbjet e shkaktuara nga ekzekutimi i një urdhri i cili përmban të dhëna të gabuara.

10.5. Përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, urdhrat do të pranohen nga Banka vetëm gjatë orarit zyrtar të punës. Nëqoftëse Banka merr ndonjë urdhër të postuar ose dërguar me mjete të tjera pas orarit zyrtar të punës, ose nëqoftëse një urdhër pagese merret pas kohës së paracaktuar në kontratë, këto urdhra do të konsiderohen se janë marrë në ditën e nesërme të punës. Në përputhje me procedurat e saj të brendshme, Banka vulos gjithë postën e ardhur ose të dërguar me datën dhe orën e saktë të arritjes.

10.6. Banka zbaton legjislacionin shqiptar lidhur me ditët e pushimit dhe festat zyrtare. Orari i punës i Bankës mund të ndryshojë nga Banka në cdo kohë që Banka e gjykon të arsyeshme.

10.7. Data e ekzekutimit të një urdhri pagese do të gjykohet data në të cilën Banka merr udhëzimin nga Klienti, me kusht që (i) urdhri i pagesës të jetë marrë brenda kohës së rënë dakort nga Banka dhe Klienti për të ekzekutuar një udhëzim të tillë; (ii) të ketë gjendje të mjaftueshme në llogarinë e Klientit përkatës në ditën kur Banka ka marrë urdhrat; (iii) Klienti të ketë paraqitur në Bankë gjithë dokumentet e kërkuara në bazë të legjislacionit shqiptar në mënyrë që të ekzekutohet urdhri i pagesës.

11. Ekzekutimi i Urdhrave

11.1. Klienti pranon që Banka të kërkojë një periudhë kohe të arsyeshme për të ekzekutuar urdhrat sipas natyrës dhe kompleksitetit të tyre, praktikave të përgjithshme të biznesit të bankave në Shqipëri, si edhe ligjeve, rregulloreve dhe akteve ligjore në fuqi.

11.2. Në rast se Klienti kërkon ekzekutimin e një

urdhri i cili nuk është në përputhje me praktikat e rregullat ose një datë të specifikuar, Banka mund të kerkoje rregullimin e te metave dhe brenda nje kohe te arsyeshme sipas vendimit dhe gjykimit te vetem te saj, te pezulloje kryerjen e veprimit. Eshte ne gjykimin dhe diskrecionin e Bankes per te vendosur pezullimin ose ekzekutimin e urdherit. Banka nuk mban pergjegjesi per humbje te shkaktuara si rrjedhoje e fajit te Klientit ne plotesimin e urdhrat.

Bankës do t'i jepet koha e mjaftueshme për veprim, ekzekutim ose dërgim. Banka nuk do të ketë detyrim për dëmtimet ose humbjet e shkaktuara nëqoftëse nuk i jepet koha e mjaftueshme.

11.3. Përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, Banka do të ekzekutojë urdhrat njëri pas tjetrit sipas kohës së arritjes së tyre. Regjistrimet e Bankës do të bëhen sipas kohës së arritjes.

11.4. Telefonatat e bëra për konfirmimin e urdhrave të pagesës të marra nga Klienti do të regjistrohen për mbrojtjen dhe ruajtjen e interesave të biznesit të Klientit dhe Bankës dhe do të kualifikohen si sekrete bankare dhe trajtohen në përputhje me Seksionin 3 të KPB.

11.5. Nëqoftëse urdhrat e pagesës nuk mund të ekzekutohen për shkak të shumës së pamjaftueshme në llogarinë e Klientit, Banka mund: a) te mos pranoje urdherin; b) te ekzekutoje urdherin e Klientit vetem per shumen e ndodhur ne llogari duke marre per kete veprim edhe pelqimin paraprak te Klientit ose c) të pezullojë ekzekutimin derisa të kreditohet një shumë e mjaftueshme në llogari dhe pastaj të ekzekutojë udhëzimet sipas faturës dhe sipas udhëzimeve origjinale. Banka nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e udhëzimeve për shkak të shumës së pamjaftueshme në llogarinë e Klientit.

11.6. Banka do të njoftojë Klientin me shkrim për ekzekutimin e urdhrave. Nëqoftëse, brenda 15 ditëve pas marrjes së një njoftimi të tillë, nuk bëhet asnjë kundërshtim nga Klienti, Banka e konsideron ekzekutimin e udhërit të pranuar nga Klienti në mënyrë të përvokueshme.

12. Tërheqja dhe Ndryshimi i Urdhrave

Klienti mund të tërheqë ose të ndryshojë një urdhër pagese vetëm në rast se përfituesi i këtij urdhri nuk është informuar për një urdhër të tillë, ose llogaria e Klientit nuk është debituar, pavarësisht nga fakti se cili veprim ndodh më parë. Gjithë kostot e rrjedhura nga tërheqja ose ndryshimi i një urdhri pagese do të mbulohen nga Klienti. Banka nuk mban përgjegjësi për humbjet e Klientit që rrjedhin nga tërheqja ose ndryshimi i një urdhri pagese.

13. Hapja e Llogarisë

13.1. Banka do të hapë një llogari vetëm nëqoftëse Klienti dorëzon në Bankë dokumente që vërtetojnë identitetin e Klientit në përputhje me Seksionin 5 të KPB, të cilat kërkohen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të vecanta të Bankës së Shqipërisë.

13.2. Gjithë llogaritë bankare të hapura dhe të mbajtura nga Banka mbajnë emrin e Klientit/emrin e shoqërisë si dhe një numër llogarie i cili përcaktohet në marrëveshjen për hapjen e llogarisë. Kur një Klient hap disa llogari në emrin e tij, këto llogari përbëjnë një tërësi llogarish dhe trajtohen si të ndara vetëm për qëllime të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Klientit.

13.3. Sa kohë që marrëveshjet për hapje llogarie janë në fuqi, Banka pranon fonde të transferuara në favor të Klientit dhe krediton këto fonde në llogaritë përkatëse.

13.4. Klienti mund të lëshojë autorizim për të vepruar me llogaritë e tij për të tretët. Ky autorizim duhet t'i jepet Bankës me një instrument me shkrim i cili përmban hollësitë dhe afatin e autorizimit.

13.5. Nëse klienti nuk ka kryer asnjë veprim në llogari për një periudhë një vjeçare, llogarie do të bëhet llogari pasive – e fjetur. Një llogari mund të përdoret dhe bëhet aktive, pasi t'i kenë hequr statusin pasiv – e fjetur, dhe një gjë tillë mund të behët duke kryer transaksione në sportelet e bankës.

14. Nxjerrja e Llogarisë

14.1. Banka i siguron Klientit vetëm nese marreveshja midis paleve e parashikon dhe kundrejt nje shperblimi

te caktuar (shperblimi dhe masa e tij do te vendoset dhe ndryshohet sipas gjykimit dhe diskrecionit te vetem te Bankes), nxjerrjen periodike te gjendjes se llogarise e cila konfirmon cdo debi dhe kredi te ndodhur ne llogarinë e Klientit si edhe bilancin e llogarisë.

14.2. Nëse ka pretendime në lidhje me bilancin ose me elementë të llogarisë, Klienti duhet të njoftojë Bankën me shkrim brenda 15 ditëve nga data e marrjes së nxjerrjes së llogarise përkatëse, në mungesë të të cilit Banka e konsideron nxjerrjen e llogarise të konfirmuar dhe të pranuar në mënyrë të pakthyeshme nga Klienti.

14.3. Banka ka të drejtën, pa njoftuar paraprakisht Klientin, të korrigjojë gjithë gabimet në kredi/debi nga debitimi/kreditimi i llogarisë në cdo kohë. Banka do të njoftojë Klientin për korrigjimin e ndodhur me mjetet e saj te komunikimit.

14.4. Banka ka vënë në dispozicion të klientëve të vet shërbimin e Postës Bankare. Çdo njoftim i Bankës për klientët e saj sipas Kushteve të Përgjithshme të Punës, pasqyrë llogarie, faturë ose çdo njoftim tjetër me shkrim ose i printuar nga sistemi kompjuterik mund të tërhiqet pranë Postës së Bankës në çdo kohë brenda orarit të punës të Bankës.

15. E drejta për Kompensim

15.1. Klienti është në dijeni dhe pranon që gjendja në llogarinë e tij shërben si mbulim kundrejt detyrimeve të Klientit ndaj Bankës. Nëqoftëse Klienti nuk përmbush në kohë ndonjë detyrim që ka për t'i paguar Bankës, Banka, sipas ligjit Shqiptar, ka të drejtë të debitojë gjëndjen në llogarinë e Klientit për shumën e detyrimit monetar të Klientit duke kryer kompensimin e detyrimit.

15.2. Nëqoftëse Klienti nuk përmbush detyrimet e tij për të paguar Bankën, Banka ka të drejtë të pezullojë ekzekutimin e udhëzimeve për të paguar të tretët nga llogaria e Klientit. Banka nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dëm ose humbje që rezulton nga ky veprim.

15.3. Detyrimet e përcaktuara në valutë të huaj do të kompensohen me kursin e këmbimit që Banka vendos për blerjen e kësaj valute të huaj, ose me një kurs këmbimi që Banka mund të vendosë në mënyrë të arsyeshme, në ditën kur bëhet kompensimi.

III. TRANSAKSIONE TE VECANTA

16. Depozitat

16.1. Banka do të pranojë nga Klienti depozita në lekë dhe valutë të huaj në përputhje me rregulloret në fuqi të Bankës së Shqipërisë.

16.2. Pagesa e interesit mbi depozitat, përderisa nuk është rënë dakort ndryshe, bëhet me maturimin e depozitës. Për llojin e interesit që do të aplikohet - fiks ose i ndryshueshëm - Banka dhe Klienti bien dakort që në fillim të transaksionit për depozitën.

16.3. Banka do të zbresë tatimet e mbajtur ne burim dhe tatime të tjera, nëse ka, për interesin e paguar si mund të kërkohet nga ligji Shqiptar. Zbritja e tatimeve të ndaluara do të bëhet në të njëjtën ditë në të cilën paguhet interesi.

16.4. Për disa lloje të transaksioneve të depozitës me karakteristika të vecanta ose në përputhje me një marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Klientit, do të zbriten shpenzimet dhe tatimet e realizuara dhe Klienti do të informohet për këtë.

16.5. Banka do të konfirmojë kushtet për të cilat është rënë dakort për depozitat duke i dërguar Klientit një njoftim me shkrim. Kundërshtimet në lidhje me këto kushte duhet t'i njoftohen Bankës me shkrim brenda 15 ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi, në mungesë të të cilit Banka do t'i konsiderojë kushtet të konfirmuara dhe të pranuara në mënyrë të pakthyeshme nga Klienti.

16.6. Klienti bie dakort që depozitat të shërbejnë për kompensimin e detyrimeve të Klientit kundrejt Bankës.

17. Kreditë

17.1. Banka mund të japë kredi vetëm në përputhje me kushtet e politikës së Bankes dhe duke zbatuar një marrëveshjeje kredie me shkrim. Banka mund të japë cdo lloj kredie kundrejt garancive të kredisë të pranueshme nga Banka. Keto garanci kredie mund të përfshijnë pa kufizim kambiale, nota premtimi, garanci mbi aktivet, hipotekë, mbulesë financiare në cash, garanci

të pranueshme nga Banka, transferim i të drejtës mbi arkëtimet, letra me vlerë, si dhe cdo garanci reale ose personale mbi sende të luajtshme, të paluajtshme, të drejta etj.

17.2. Banka do të vlerësojë cdo aplikim për kredi në bazë individuale dhe sipas gjendjes financiare, ligjore dhe ekonomike të Klientit në kohën e aplikimit, dhe cilësisë së mjeteve të ofruara për sigurimin e kredisë.

17.3. Nëse si rezultat i ndryshimit të një ligji ose rregulloreje, ose ndryshim në kërkesën e autoritetit drejtues ose rregullator të Bankës së Shqipërisë, do të ketë një rritje në kostot e Bankës për të bërë, financuar ose mbajtur një kredi, Klienti do të rimburojë Bankën me shumën e mjaftueshme për të kompensuar Bankën për këtë rritje të kostos.

17.4. Lidhur me llogaritë që kanë më shumë se një titullar llogarie, në rastin e dhënies së kredive individuale nga Banka është e domosdoshme të merret pëlqimi i të gjithë titullarëve të llogarisë, në të kundërt veprimi nuk është i vlefshëm.

18. Kambialet dhe Ceqet

18.1. Nëqoftëse Banka skonton kambialet ose bën pagesa kundrejt ceqeve që i jepen Bankës për të paguar, Banka ka të drejtë të debitojë Klientin me shumën e paguar nga Banka plus interesin dhe shpenzimet, nëse këto kambiale dhe ceqe nuk janë paguar në momentin e dorëzimit dhe në rastet kur (i) pagesa për këto kambiale ose ceqe është e kufizuar me ligj ose rregullore, ose (ii) kambialet dhe ceqet nuk mund të paraqiteshin fare ose brenda një periudhe kohe të caktuar për shkak të pengesave që nuk mund të kapërceheshin, ose (iii) është deklaruar një moratorium, ose (iv) në vend zhvillohen rrethana të ngjashme kur kambialet dhe ceqet duhet të paguhen, dhe edhe nëqoftëse kambialet dhe ceqet nuk janë në dispozicion të Bankës.

18.2. Banka ka të drejtë të debitojë Klientin me shumën e kambialeve të skontuar nëqoftëse Banka nuk merr informacion të mjaftueshëm në lidhje me palën që është e detyruar të paguajë kambialin ose nëqoftëse kjo palë ka kundërshtuar pagesën, ose nëqoftëse ka një ndryshim të rëndësishëm negativ në gjendjen ekonomike dhe ligjore të kësaj pale.

18.3. Në bazë të kërkesës Klienti do të transferojë në Bankë gjithë pretendimet e rrjedhura nga transaksioni mbi bazën e të cilit ishte nxjerrë kambiali dhe gjithë të drejtat aktuale dhe të ardhme lidhur me transaksionin, duke përfshirë letrat me vlerë.

18.4. Banka do të respektojë kambialet që paraqiten në Bankë për pagesë nëqoftëse Klienti ka dhënë fondet e nevojshme.

18.5. Në lidhje me kambialet dhe ceqet që nuk janë të pagueshëm nga një institucion financiar ose të cilët janë të pagueshëm jashtë Shqipërisë, Banka nuk do të jetë përgjegjëse për paraqitjen, ankimin ose njoftimin e duhur.

19. Letrat e Kreditit

19.1. Banka mund të marrë parasysh kërkesat e Klientit për të hapur letra krediti. Në masën që Banka pajtohet me një kërkesë të tillë, Banka do të hapë letra krediti vetëm në kushtet e pranuar nga Banka, duke përfshirë, pa kufizim, fonde të Klientit për të bërë sigurimin e duhur të pranueshëm nga Banka. Në mungesë të këtyre mjeteve të sigurimit, Banka mund të refuzojë kërkesën.

19.2. Banka mund të pranojë kërkesën për të hapur një Letër Krediti vetëm me formularin e parapërgatitur nga Banka. Në rast se Klienti dëshiron të ndryshojë ose të shtojë dicka në kushtet e këtij formulari, Klienti duhet ta paraqesë këtë kërkesë me shkrim të firmosur sipas rregullit. Banka mund të pranojë ose të refuzojë ndryshime ose shtesa të tilla.

19.3. Klienti do të paraqesë kërkesën për të hapur një Letër Krediti në kohën e duhur për t'i dhënë Bankës mundësi për t'i komunikuar përfituesit këtë Letër Krediti nëpërmjet një banke korespondente ose drejtpërdrejt, ose në rastin kur banka është e konfirmuar, asaj banke. Banka nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëm ose humbje që mund të rezultojë nga vonesa ose refuzimi për të hapur një Letër të tillë Krediti.

19.4. Vetëm Klienti mban përgjegjësi për të dhënë udhëzime të plota dhe të qarta që përshkruajnë dokumentet dhe kushtet në të cilat duhet të bëhet pagesa, pranimi ose negociata për një Letër Krediti. Banka nuk do të jetë e detyruar të paguajë nëqoftëse

paraqiten dokumente të cilat nuk janë të njëjta me kushtet e përcaktuara në Letrën e Kreditit, përderisa Klienti nuk do të kërkojë me shkrim që Banka duhet të pranojë këto dokumente për pagesë dhe të bjerë dakort për të dëmshtëpërbyer Bankën kundrejt dëmeve ose humbjeve që mund të rezultojnë si rezultat i kësaj kërkesë.

19.5. Klienti njih përgjegjësinë për të siguruar që kërkesat e tij për të hapur një Letër Krediti nuk bien në kundërshtim me legjislacionin dhe rregulloret shqiptare në fuqi. Nëqoftëse Klienti nuk përmbush këto kushte, Banka do të refuzojë kërkesën. Nëqoftëse Bankës i shkaktohet ndonjë dëm ose humbje lidhur me mospërmbushjen nga Klienti të ligjeve dhe rregulloreve, Klienti është i detyruar të rimbursojë Bankën për gjithë dëmet ose humbjet e shkaktuara.

19.6. Për zbatimin e udhëzimeve lidhur me letrat e kreditit Banka ndjek rregullat e caktuara në broshurën nr.500 Rregullat dhe Praktikrat Uniforme për Kredine Dokumentare dhe normat e uniformizuara se bashku me konsekuencat e mepasshme nxjerrë dhe ndryshuar herë pas here nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë. Klienti do të njohë natyrën detyruese të këtij dokumenti në zbatimin e tij.

20. Paraqitja e dokumenteve për pagesë

20.1. Banka mund të marrë parasysh, kundrejt pagesës, kërkesën e Klientit për të ekzekutuar pranimin dhe/ose pagesën ose dërgimin e dokumenteve tregtare ose transaksione të tjera lidhur me paraqitjen e dokumenteve për pagesë në kushtet e pranuar nga Banka dhe sipas rregullave të përcaktuara në broshurën nr.322 Rregullat dhe Praktikrat Uniforme për Paraqitjen e Dokumenteve për Pagesë nxjerrë dhe ndryshuar herë pas here nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë. Klienti do të njohë natyrën detyruese të këtij dokumenti në zbatimin e tij.

20.2. Banka do të paguajë një të tretë sipas kërkesës së Klientit, me kusht që në llogaritë e Klientit të ketë fonde të mjaftueshme.

20.3. Klienti njih përgjegjësinë për të siguruar që kërkesa e tij për të mbledhur dokumentet për pagesë nuk bie në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret shqiptare në fuqi. Nëqoftëse Klienti nuk përmbush këtë kusht, Banka

do të refuzojë kërkesën. Nëqoftëse Bankës i shkaktohet ndonjë dëm ose humbje lidhur me mospërmbushjen nga Klienti të ligjeve dhe rregulloreve, Klienti është i detyruar të rimbursojë Bankën për gjithë dëmet ose humbjet e shkaktuara.

20.4. Nëqoftëse Banka vepron sipas kërkesës së një Klienti i cili është përfituesi i paraqitjes së dokumenteve për pagesë, Banka do të jetë agjenti i përfituesit për qëllimet e paraqitjes së dokumenteve dhe marrjes së pagesave.

21. Garancitë e Bankës dhe Dorezanite (Surety)

21.1. Banka mund të marrë parasysh kërkesat nga Klienti për, të leshuar garanci bankare, ose dorezani. Në masën që Banka pranon një kërkesë të tillë Banka do të leshojë garanci bankare ose do të behet dorezanes, në kushtet e pranuar nga Banka, duke përfshirë, pa kufizim, fondet e Klientit për të bërë sigurimin e duhur të pranuar nga Banka. Në mungesë të një sigurimi të tillë, Banka mund të refuzojë kërkesën. Klienti pranon që në rast të kërkesës së tij për leshimin e garancive bankare, ai është dakort të perdore tekstet e garancive bankare të ofruara nga Banka. Banka gezon të drejtën të refuzojë tekstin e garancise të propozuar nga Klienti në rast se ai është i ndryshëm nga tekstet e Bankes.

21.2. Një garanci bankare e leshuar nga Banka në favor të një të treti (Përfituesi) është një detyrim i pavarur i Bankës dhe do të kryhet sipas kushteve të përcaktuara në garanci. Transaksioni ndërmjet Klientit dhe të tretit si dhe konfliktet ndërmjet tyre me baze marreveshjen e lidhur midis tyre nuk e përfshijnë Bankën drejtpërsëdrejti, e cila pavaresisht nga mosmarreveshjet e mundshme midis Klientit dhe të tretit në favor të të cilit është leshuar garancia, detyrohet të kryejë pagesën me kërkesën me të parë të të tretit dhe të kërkojë apo të debitojë menjëherë nga Klienti nga shuma e bllokuar për leshimin e garancise, shumën e kërkuar për pagim.

21.3. Nëqoftëse Banka lëshon një garanci bankare ose behet dorezanes, me udhëzimin e Klientit të saj dhe bën pagesë në bazë të garancise ose dorezanise, Klienti me kërkesën e parë të Bankës, do të rimbursojë Bankën dhe ky rimbursim duhet bërë menjëherë pasi Banka bën një pagesë të tillë.

21.4 Klienti kupton dhe garanton se nuk do të ketë asnjë pretendim kundrejt Bankes për kryerjen e pagesës sipas garancisë dhe në rast se do të ekzistojë një mosmarrëveshje midis tij dhe të tretit (Perfituesit) lidhur me transaksionin kryesor midis tyre duke pretenduar se i treti nuk duhej të kishte kërkuar kryerjen e pagesës, do t'i drejtohet të tretit (Perfituesit), ndërsa Banka është e përjashtuar nga përgjegjësia.

22. Shërbimet e Ruajtjes së Letrave me Vlerë

22.1. Banka mund të marrë parasysh kërkesat nga Klienti për të ofruar shërbime të ruajtjes së letrave me vlerë në përputhje me kushtet e një marrëveshjeje të vecantë për shërbimet e ruajtjes, ku ajo pranon letra me vlerë nga Klienti për ruajtje të sigurt dhe ndërmerr mbledhjen e interesit, dividendëve, ose shitjen/lëvrimin e fitimeve në lidhje me këto letra me vlerë të mbajtura në ruajtje nga Banka dhe transferon fonde lidhur me to në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

22.2. Në raste kur Banka i ofron Klientit vetëm shërbime të ruajtjes, nuk do të zbatohen dispozitat e KPB për këtë rast. Gjithë transaksionet lidhur me shërbimet e ruajtjes së letrave me vlerë do të rregullohen sipas kushteve të marrëveshjes së vecantë për shërbimet e ruajtjes për të cilën kanë rënë dakort Klienti dhe Banka.

23. Transaksione të Këmbimeve Valutore

23.1. Banka kryen pagesa ndërkombëtare dhe transaksione të këmbimeve valutore në përputhje me rregullohet e këmbimit valutore në fuqi.

23.2. Banka mund të zbatojë udhëzime për blerjen ose shitjen e valutës së huaj si një agjent tregtar i Klientit duke kontraktuar në emrin e vet pa qenë e detyruar t'i bëjë të ditur Klientit kushtet e transaksioneve të tilla.

23.3. Banka zbaton këmbimet spot ose forward të valutës së huaj në ose nga leku shqiptar me kursin e caktuar nga Banka dhe të pranuar nga Klienti.

23.4. Përderisa nuk është përcaktuar ndryshe, Banka nuk do të mbajë përgjegjësi për rreziqe të rrjedhura nga fluktuacionet e kurseve të këmbimit në rrjedhën e kryerjes së pagesave ndërkombëtare dhe transaksioneve të këmbimeve valutore. Nëqoftëse Banka bën shpenzime

ose pëson dëme për shkak të fluktacionit të kursit të këmbimit, Klienti do të rimburojë Bankën për shpenzime ose dëme të tilla.

23.5. Banka do të ketë të drejtë të regjistrojë të gjithë bisedat telefonike, si të brendshme edhe të jashtme, të bëra ndërmjet Klientit dhe punonjesve të Bankës dhe Klienti duhet të miratojë këto regjistrime. Kasetat me regjistrime të tilla do të cilësohen si sekrete të Bankës dhe do të shërbejnë dhe përdoren vetëm si provë në rast marrëveshesh ose ndryshimesh të cilat mund të ngrihen ndërmjet Palëve dhe do të mbahen në përputhje me Seksionin 3 të KPB.

24. Shërbime Bankare On-line

24.1 Banka ofron shërbime bankare on-line (Internet Banking). Fjalekalime (passworde) të tilla si (numri i identifikimit, vendi dhe emri i përdoruesit ashtu si edhe online password) mundësojnë përdorimin e këtyre shërbimeve.

Banka gëzon të drejtën e veprimit sipas udhëzimeve të klientit me fjalekalim (password). Përdorimi i fjalekalimit (passwordit) nga ana e Klientit është i barasvlefshëm me firmën e tij që e autorizon Bankën të kryejë transaksione ose kërkesa që mund t' i komunikohen Bankës.

Megjithatë, çelësat konsiderojnë Klientin përdoruesin e autorizuar të Shërbimeve bankare, Klienti njofton menjëherë Bankën në rastin kur kompromentohet mirëbesimi i tyre. Klienti gjithashtu nuk është i autorizuar të japë informacion lidhur me fjalekalimet personave të paautorizuar.

Klienti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve, kur ose ndonjë përdorues tjetër ka të drejtën e autorizimit, edhe kur personi ia kalon të drejtën e përdorimit të tjerëve.

Klienti është gjithashtu përgjegjës për të gjitha transaksionet nga cdo përdorues i autorizuar deri në momentin kur Klienti njofton Bankën në lidhje me revokimin e së drejtës në mënyrë që dhe deri në momentin kur Banka të marrë masat e domosdoshme për të bllokuar aksesin e fjalekalimit.

24.2 Banka nuk do të jetë përgjegjëse për cdo humbje që

mund të peshojë Klienti si rezultat i transferës së fondeve nepermjet shërbimeve që ofron Internet Banking.

24.3 Të gjitha njoftimet që i dërgohen Klientit duhet të jenë efikase në momentin kur Banka dërgon me postë, transmeton ata me anë të postës elektronike në adresën e njohur me të fundit ose në adresën e e-mail, që Banka disponon për Klientin në regjistrat e saj.

24.4 Banka nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëmim direkt, indirekt, të vecantë, ekonomik, apo ndonjë dëmim tjetër që mund të lindë nga instalimi ose mirëmbajtja e pajisjeve, kompjuterit të Klientit, programeve software, shërbimeve të Internet Banking-ut, çelësve, internetit, programeve në internet. Pavarësisht se Banka mund të vihet në dijeni lidhur me mundësinë apo shkaktimin e një dëmi, i vetmi person i detyruar për të marrë masat e nevojshme për shmangjen e këtij dëmi dhe që mbart pasojat është Klienti, ndërsa Banka është e përjashtuar nga çdo lloj përgjegjësie.

Në lidhje me kërkesat e të tjerëve, Klienti pranon të ruajë Bankën të pacenuar dhe nëse është rasti të rimbursojë dhe dëmshpërblejë Bankën dhe t'a konsiderojë atë të pafajshëm për dëm, humbjet, detyrimet dhe kërkesat e çfarëdo lloji.

24.5 Banka mund të ndërprejë në çdo kohë dhe për çdo arsye shërbimet bankare që ofron Internet Banking. Në këtë rast, Banka përpiqet me së miri të njoftojë Klientin para kohë, ndonëse ajo nuk është e detyruar të veprojë në këtë mënyrë.

IV. KOLATERALI

25.1. Banka ka të drejtë në çdo kohë t'i kërkojë Klientit për të dhënë kolateralin (garancite reale mbi pasuri të luajtshme ose të paluajtshme) e duhur, ose t'i kërkojë Klientit që t'i japin garanci mbi sende të tjera në masën e nevojshme për t'i siguruar Bankës ripagesën e të gjithë detyrimeve të papaguara të Klientit, edhe nëqoftëse detyrime të tilla janë kufizuar në kushte ose afat, ose pagesa nuk është kërkuar akoma. Sipas kësaj kërkesë, Klienti do të vendosë menjëherë kolateral shtesë për Bankën. Në rast se Klienti nuk e përmbush një kërkesë të Bankës atëherë ai është i detyruar të kthejë shumën e marrë kredi.

25.2. Gjithë aktiviteti dhe titujt e vendosur nga Klienti në favor të Bankës shërbejnë si kolateral për cdo dhe gjithë pretendimet që Banka mund të ketë kundrejt Klientit, përderisa nuk është rënë dakort shprehimisht që kolaterali do të përdoret për qëllime të tjera.

25.3. Klienti do të ndërmarrë gjithë veprimet e kërkuara për të ruajtur gjithë pasuritë dhe të drejtat e tij dhe për të zbatuar pretendimet e tij ndaj të tretëve të vendosura si sigurim në favor të Bankës. Klienti do të informojë Bankën me shkrim pa vonesë për cdo ndryshim në vlerë ose në likuiditet të këtij kolaterali. Nëqoftëse Klienti vendos si kolateral aktive të cilat janë përdorur ose zëvendësuar gjatë prodhimit ose tregtimit, por të cilat nuk janë përcaktuar specifikisht dhe një për një, Klienti do të zëvendësojë menjëherë aktivet e përdorura ose të shitura.

25.4. Klienti do të sigurojë me një kompani sigurimi të pranueshme nga Banka, me shpenzimet e tij, gjithë aktivet reale të vendosura si kolateral ose të fituara nga kredia e dhënë nga Banka, kur kërkohet nga Banka në kontratën e lidhur me Klientin. Sigurimi duhet të mbulojë gjithë rrisqet e siguruara. Klienti do t'i transferojë Bankës sipas policës së sigurimit ose kontratës një shumë të barabartë me gjithë pretendimet e Bankës kundrejt Klientit (të maturuara dhe të pamaturuara, të kushtëzuara e tjera). Banka mund të përdorë dëmshpërblimin e rimbursuar nga kompania e sigurimit për të pakësuar shumën e kredisë së siguruar me këtë kolateral, edhe para maturimit, nëqoftëse Klienti nuk zëvendëson sendin e humbur ose të shkatërruar të cilin e kishte vendosur si siguri ose kolateral për Bankën. Përderisa nuk përcaktohet ndryshe, cdo shumë e paguar në përputhje me policën e cila tejkalon pretendimet e Bankës kundrejt Klientit, i paguhet Klientit.

25.5. Banka ka të drejtë të inspektojë - edhe në mjediset e Klientit - nëse kolaterali është i mjaftueshëm për të mbuluar pretendimet e saj dhe nëse aktivet e vendosura si siguri mbahen mirë, ruhen dhe janë identifikuar si kolateral për Bankën.

25.6. Banka, me gjykimin e saj, mund të clirojë cdo kolateral të cilin Banka gjykon që nuk është i nevojshëm për të siguruar pretendimet e saj.

25.7. Për të realizuar një pagesë të shpejtë të

pretendimeve të saj, Banka ka të drejtë të kënaqë pretendimet e saj nga cdo aktiv i vendosur nga Klienti si sigurim, edhe nëqoftëse aktive të tjera të lëna peng/vendosura si barre siguruese, janë në dispozicion.

25.8. Kostot dhe shpenzimet lidhur me dhënien, mirëmbajtjen, funksionimin dhe aktin e heqjes së të drejtës së Klientit mbi kolateralin, përderisa nuk është parashikuar ndryshe, mbulohen nga Klienti, sipas ligjit shqiptar.

25.9. Pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës, Klienti nuk mund të transferojë aktive të vendosura në Bankë si sigurim, as mund t'i vendosë ose ofrojë këto aktive, prona, ose të ardhura si sigurim, ose për ndonjë qëllim tjetër, një të treti. Shkelja e kësaj dispozite nga Klienti mund/do të shkaktojë veprimet e specifikuar në Kapitullin V dhe/ose VI të KPB.

25.10. Klienti do të garantojë që në të gjitha rastet detyrimet e tij kundrejt Bankës të radhiten në mënyrë preferenciale në radhën e pagesave dhe në raport me gjithë detyrimet e tjera të Klientit. Klienti nuk do të sigurojë detyrimet ndaj një të treti pa siguruar ose respektuar te drejten e preferimit (privilegjit) te Bankes per t'u garantuar me aktivet, pronat ose te ardhurat e Klientit, detyrimet e tij kundrejt Bankës.

V. TE DREJTAT E BANKES NE RAST MOSPERMBUSHJEJE TE DETYRIMEVE KUNDREJT SAJ

26.1. Në rast se Klienti nuk përmbush detyrimet e tij për pagesa kundrejt Bankës në kohë, Banka do të zgjidhë pretendimin, si parashikohet me ligj, duke debituar cdo Llogari Bankare që Klienti ka në Bankë. Gjithashtu, Klienti autorizon Bankën për të debituar llogaritë e tij bankare që mbahen në banka të tjera. Klienti autorizon cdo bankë tjetër për të respektuar urdhërin e Bankës. Ne kete kuader Klienti bie dakord dhe krijon me qellim sigurimin e detyrimeve te tij, barre siguruese ne favor te Bankes, mbi gjendjen e te gjitha llogarive bankare, depozitat si dhe instrumente te tjera bankare qe Klienti ka apo do te kete ne te gjitha bankat.

26.2. Nëqoftëse Klienti nuk kryen ose nuk përmbush plotësisht detyrime të lindura nga kontrata ose nga KPB

ose Klienti është në falimentim ose likuidim, Banka do të ketë të drejtë, sipas një njoftimi me shkrim, për të deklaruar gjithë detyrimet që Klienti duhet t'i paguajë Bankës menjëherë dhe ka të drejtë t'i heqë Klientit të drejtën mbi pasurinë e lënë peng/barre siguroese të vendosur në favor të Bankës. Banka ka të drejtë të ekzekutojë gjithë pasurinë e Klientit prane Bankes, pa procedura të tjera formale ndersa per pasurite e tjera sipas Ligjit Shqiptar dhe/ose praktikës së aplikueshme. Kontrata ndërmjet Bankës dhe Klientit është, në vetvete, titull ekzekutiv.

26.3. Pamundësia dhe vonesa për të ushtruar nga ana e Bankës ndonjë të drejtë ose kompensim nuk do të interpretohet si një heqje dorë, si dhe ushtrimi i vecantë ose i pjesshëm i një të drejte ose kompensimi nuk do të pengojë ushtrimin e mëtejshëm të kësaj të drejte ose kompensimi.

VI. PERFUNDIMI I NJE MARRËDHENIEJE NGA BANKA

27.1. Në rast mospermbushje detyrimi kontraktual nga ana e Klientit ose kur garancite e vendosura në favor të Bankes humbasin ose rrezikohen të cenohen, atëherë Banka, sipas gjykimit dhe vendimit të saj mund të kërkojë nga Klienti permbushjen e detyrimeve kontraktore si dhe të refuzojë kryerjen e veprimeve të tjera bankare sipas udhëzimeve të Klientit deri në permbushjen e detyrimeve të tij; ose të zgjidhë marrëdhënien kontraktore bankare me Klientin. Zgjidhja e një marrëdhënieje bankare ndërmjet Klientit dhe Bankës nuk do të influencojë detyrimet që ekzistojnë deri në atë moment. Dispozitat e KPB dhe të kontratave të vecanta do të mbeten në fuqi plotësisht, deri në mbarimin e marrëdhënies kontraktore bankare ndërmjet Klientit dhe Bankes.

27.2. Kur Klienti është në vonesë për permbushjen e detyrimeve, detyrimet e Klientit kundrejt Bankës bëhen menjëherë të kerkueshme (të pagueshme). Në këtë rast, Banka ka të drejtë të ushtrojë menjëherë, pa njoftuar Klientin, gjithë të drejtat e saj të përcaktuara në KPB dhe legjislacionin Shqiptar të aplikueshëm.

27.3. Banka mund të refuzojë të kryejë detyrimet e saj kontraktuale kundrejt Klientit në rastet e zgjidhjes së kontratës por edhe nëqoftëse:

- a) pas pranimit dhe nënshkrimit të kontratës ndodh një ndryshim i rëndësishëm negativ në kushtet e biznesit, operationale ose ato financiare të Klientit si rezultat i të cilit nuk mund të pritet që Banka të përmbushë më tej kushtet e kontratës; ose
- b) pas pranimit dhe nënshkrimit të kontratës lind një rast mospërmbushjeje si përcaktohet në KPB ose në kontratë.

27.4. Përderisa nuk ka një marrëveshje specifike të kundërt, Banka mund të anulojë një kredi dhe/ose të zgjidhë një marrëveshje me Klientin me efekt të menjëhershëm nëqoftëse:

- a) për Bankën bëhet e pamundur të akordojë këtë hua ose kredi për qëllimet e përcaktuara në marrëveshje;
- b) Klienti e përdor këtë hua ose kredi për një qëllim të ndryshëm nga ai i përcaktuar në këtë marrëveshje;
- c) Klienti ka shkelur kushtet e marrëveshjes;
- d) Klienti është në pamundësi për të paguar shumat që duhen paguar sipas marrëveshjes;
- e) ka një ndryshim të rëndësishëm negativ në rrethanat ligjore, financiare ose kushte të tjera të Klientit dhe ndryshime të tilla janë konsideruar nga Banka si ndryshime që kanë efekte negative në pagesën e detyrimeve të Klientit;
- f) cdo paraqitje e bërë nga Klienti në lidhje me marrëveshjen në fjalë është bërë në mënyrë jokorrekte ose corientuese, dhe/ose nëqoftëse Klienti ka mashtruar Bankën duke i dhënë asaj deklarata fallse të fakteve, ose duke i fshehur informacion, ose në cdo mënyrë tjetër;
- g) Klienti nuk përmbush detyrimet ose shkel garancinë për një marrëveshje kredie të nënshkruar me një palë të tretë që do t'i lejonte kësaj pale të tretë të shpejtonte rikthimin e parave, ose të zgjidhte para maturimit marrëveshjen e kredisë së nënshkruar me Klientin;
- h) Klienti ndërmer detyrime, ose ofron sigurim për kreditorë të tjerë ndërsa ka te papaguar detyrimet e veta (principalin (kryegjene), interesin, ose detyrime të tjera) kundrejt Bankës, si rezultat i të cilit detyrimet e Klientit kundrejt Bankës ose të tretëve bëhen më të rënda, ose pretendimet e Bankës rrezikohen, përderisa Klienti nuk zbaton sigurim preferencial dhe te drejte preferimi (privilegji) për Bankën, të pranuar nga Banka;
- i) Klienti, entet në varësi të tij, ose degët e tij nuk

- paguajnë borxhet e tyre të maturuara;
- j)** Klienti, entet në varësi të tij, ose degët e tij janë në gjendjen e paaftësisë paguese, falimentimit, ose ndonjë prej tyre është nën procedurën e likuidimit;
 - k)** Klienti pengon Bankën për të inspektuar, ose nuk përmbush detyrimet e tij për t'i dhënë informacionin e duhur Bankës si përcaktohet në marrëveshje ose me ligj;
 - l)** Klienti nuk paguan sipas një vendimi të formës së prerë ose urdhër të Gjykatës; ose
 - m)** cdo shkelje tjetër e përcaktuar me ligjin Shqiptar.

VII. TARIFAT BANKARE

28. Interesi

28.1. Përqindjet e interesit përcaktohen në kontratën e lidhur ndërmjet Klientit dhe Bankës.

28.2. Nëqoftëse përqindja e rifinancimit të Bankës ndryshon si rrjedhojë e masave të marra nga Banka e Shqipërisë, dhe/ose vijnë si rezultat i ndryshimeve në tregun e parasë, Banka mund të rritet ose ulet këto përqindje duke njoftuar Klientin me shkrim ose nëpërmjet një njoftimi publik.

28.3. Në rastin e vonesës në pagesa Klienti do të paguajë kamatë si përcaktohet me ligj ose në kontratë.

28.4. Nëqoftëse kontrata përfundon për cdo lloj arsyeje para afatit, interesi do të bëhet menjëherë i pagueshëm.

28.5. Nëqoftëse kontrata përfundon për cdo lloj arsyeje para afatit, interesi ashtu si edhe të gjitha detyrimet e tjera monetare të Klientit kundrejt Bankës, do të bëhet menjëherë i pagueshëm.

28.5. Nëqoftëse Klienti nuk paguan interesin në kohën e duhur, Banka ka të drejtë të debitojë shumën e interesit që duhet paguar në ndonjë nga llogaritë e Klientit të hapura në bankë.

29. Tarifat

29.1. Tarifat, komisionet, dhe shpenzime të tjera të vendosura nga Banka përcaktohen në Kushtet e vëna

nga Banka. Këto kushte mund të ndryshohen herë pas here sipas gjykimit të vetë Bankës.

29.2. Klienti duhet të paguajë tarifat, komisionet dhe shpenzime të tjera në përputhje me dispozitat e marrëveshjes ndërmjet Klientit dhe Bankës dhe Banka ka të drejtë të debitojë nga llogaria e Klientit të gjitha shumat perkatese të tarifave, komisioneve dhe shpenzimeve të tjera.

30. Tarifat për shërbime juridike

30.1. Klienti do të rimbursojë Bankën për gjithë tarifat për shërbime juridike të bëra nga Banka në lidhje me një transaksion të vecante, duke përfshirë shpenzimet për shërbimet e kryera nga konsulentët, vlerësuesit, ekspertët kontabël etj.

30.2. Klienti do të rimbursojë Bankën për gjithë kostot e avokatit të bëra nga Banka për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet Klientit dhe Bankës, përderisa nuk vendoset ndryshe nga gjykata ose arbitri.

30.3. Klienti do të rimbursojë Bankën për gjithë shpenzimet e bëra në ose jashtë gjykatës kur Banka përfshihet në procedura ligjore ose mosmarrëveshje ndërmjet Klientit dhe një të treti.

31. Kosto të tjera

Klienti do të rimbursojë Bankën për gjithë kostot dhe shpenzimet e tjera të bëra nga Banka në lidhje me transaksione të vecanta, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në kostot e telekomunikacionit, korrierit, dhe shpenzime të tjera lidhur drejtpërdrejt me transaksionin. Ky detyrim i Klientit nuk varet nga fakti nëse transaksioni është përmbushur ose është ekzekutuar, ose detyrimi/angazhimi ka përfunduar.

VIII. TË NDRYSHME

32. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

32.1. Klienti dhe Banka do të përpiqen të zgjidhin gjithë mosmarrëveshjet juridike të lindura nga marrëdhëniet e tyre nëpërmjet bisedimeve, duke shmangur dërgimin e çështjes në gjykatë.

32.2. Përderisa nuk është përcaktuar ndryshe, në rast se Klienti dhe Banka nuk mund të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre nëpërmjet bisedimeve, mosmarrëveshja do të paraqitet në gjykatën kompetente. Në rast se ka më shumë se një gjykatë kompetente, palët do të paraqiten në Gjykatën e Tiranës.

33. Ndarja e ndikimit ndërmjet dispozitave - Ndashmëria

Nëqoftëse një ose më shumë nga dispozitat e KPB ose të ndonjë kontrate do të përcaktohen si të pavlefshme, joligjore, ose të pazbatueshme sipas legjislacionit në fuqi, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të KPB ose kontratës nuk do të influencohet ose dobësohet në asnjë mënyrë.

34. Legjislacioni i zbatueshëm

Për gjithë çështjet e parregulluara me marrëveshjen e lidhur ndërmjet Klientit dhe Bankës herë pas here, do të zbatohen dispozitat në fuqi të legjislacionit shqiptar, të Kodit Civil shqiptar, ligjet dhe rregulloret përkatëse të Bankes së Shqiperise që rregullojnë aktivitetin bankar dhe atë financiar. Raportet e përgjithshme të biznesit ndërmjet Klientit dhe Bankës do të rregullohen nga dispozitat e KPB.

